

# Përgatitja e Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në BE: të bllokuar në trashëgiminë e Gruevskit



Mars 2023

# Përmbajtja

<b>HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>ÇFARË JANË RAPORTET E PROGRESIT?</b>	<b>4</b>
<b>ÇFARË ZBULOJNË RAPORTET E KOMISIONIT EVROPIAN PËR PROGRESIN E VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR?</b>	<b>4</b>
<b>VLERËSIMI I PËRGATITJES SË MAQEDONISË SË VERIUT NDËR VITE</b>	<b>5</b>
Përgatitja e Maqedonisë së Veriut sipas klasterëve të negociatave	7
<b>KONKLUZION</b>	<b>13</b>

Në vitin 2020, Komisioni Evropian ka miratuar një metodologji të re për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). Përmes metodologjisë së re, 33 kapitujt e legjislacionit evropian (të njohur si “acquis communautaire”) ndahen në 6 grupe, apo kllasterë:

1. Parimet themelore
2. Tregu i brendshëm
3. Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse
4. Axhenda e gjelbër dhe lidhje të qëndrueshme
5. Burimet natyrore, bujqësia dhe kohezioni
6. Marrëdhëniet e jashtme

Ky kllasterizim është paraparë t’i bëjë negociatat me të parashikueshme, më të racionaluara dhe më politike, duke forcuar qasjen kushtëzuese në lidhje me shtetin e së drejtës: kllasteri 1, Parimet themelore dhe shteti i së drejtës, hapet i pari dhe mbyllet i fundi.

Krahas kësaj, Komisioni Evropian vazhdon vlerësimin vjetor të progresit për secilin kapitull veç e veç. Raportet e progresit të Komisionit Evropian vlerësojnë përgatitjen e ligjeve, institucioneve dhe politikave të vendeve candidate dhe candidate potenciale për të zbatuar legjislacionin evropian. Në Ballkanin Perëndimor, vende candidate janë Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria. Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova janë vende candidate potenciale.

Që nga viti 2015, qasja e raporteve të progresit të Komisionit Evropian është dizajnuar për të krijuar më tepër besueshmëri nga ana e vendeve anëtare, përmes një vlerësimi më objektiv dhe më të vështirë për vendet candidate.

Viti 2015 rastis të jetë edhe viti i fundit të qeverisjes Gruevski, meqë ky i fundit dha dorëheqje nga posti i Kryeministrit në janar 2016, ndërsa qeverisja SDSM-BDI filloi në maj 2017. Gjatë këtyre viteve, qeveria SDSM-BDI ka miratuar një sërë strategjish për reforma evropiane, duke filluar nga Plani 3-6-9 në vitin 2018, Plani 18 një vit më vonë, si dhe në vitin 2021, Aksion 21 dhe plani Evropa në Shtëpi.

Por cili ka qenë impakti real i këtyre planeve për reforma nga ana e qeverive Zaev I dhe II dhe së fundimi i asaj Kovaçevski? Apo me fjalë tjera, çfarë zbulojnë raportet e progresit të Komisionit Evropian në lidhje me arritjet e qeverive suksesive SDSM-BDI në rritjen e përgatitjes së Maqedonisë së Veriut për t’u bërë anëtare e Bashkimit Evropian?

**Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi ka analizuar raportet e progresit të Komisionit Evropian duke filluar nga viti 2015 e deri në raportin e fundit, të vitit 2022, për të vlerësuar impaktin e reformave të qeverive SDSM-BDI në përafrimin e Maqedonisë së Veriut me BE-në.**

## ÇFARË JANË RAPORTET E PROGRESIT?

Raportet e progresit janë vlerësim sistematik vjetor nga ana e Komisionit Evropian që kanë të bëjnë me zemrën e evropianizimit. Ato analizojnë progresin e arritur nga vendet candidate në 33 kapitujt e negociatave, me ligje, politika dhe institucione funksionale, si dhe një historik të zbatimit të reformave evropiane.

Komisioni Evropian analizon çdo fushë politike, apo kapitull, duke përdorur pesë shkallë që vlerësojnë përgatitjen për anëtarësim në BE të vendeve candidate dhe candidate potenciale:

1. Fazë e hershme
2. Përgatitje e deridikushme
3. Përgatitje mesatare
4. Përgatitje e mirë
5. Përgatitje mirë e avancuar

Për nevojat e kësaj analize, Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi ka përkthyer në nota secilën shkallë të përgatitjes: prej 1 për notën më të keqe (“fazë e hershme”) e deri në 5 për më të mirën (“përgatitje e avancuar mirë”). Për t'i bërë më të lexueshme këto 5 shkallë përgatitjeje, kemi përdorur system me ngjyra si vijon:

<i>Gjendja e përgatitjes për anëtarësim në BE</i>	<i>Nota</i>
Fazë e hershme	1
Përgatitje e deridikushme	2
Përgatitje mesatare	3
Përgatitje e mirë	4
Përgatitje mirë e avancuar	5

## ÇFARË ZBULOJNË RAPORTET E KOMISIONIT EVROPIAN PËR PROGRESIN E VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR?

Kur analizohen dhe krahasohen raportet e progresit për vendet e Ballkanit Perëndimor nga viti 2015, në nivel të përgjithshëm, dalin tre konkluzione.

- Së pari, vlerësimi mesatar nga Komisioni Evropian i 33 kapitujve për vendet e Ballkanit Perëndimor tregon se Mali i Zi (3.1), Serbia (3), Maqedonia e Veriut (3) janë më të përgatiturat, me një shkallë përgatitje mesatare. Shqipëria ka përgatitje të deridikushme

(2.6). Kosova (1.9) dhe Bosna-Hercegovina (1.7) janë ende në fazë të hershme të përgatitjes (figura 1).



Figura 1

- Së dyti, vendet që kanë qenë më gjatë në këtë proces kanë ngadalësuar progresin e tyre viteve të fundit. Pra, raportet e progresit tregojnë se procesi i deritanishëm i zgjerimit ka dështuar të nxisë reforma të mirëfillta.
- Së treti, fokusi i ri në parimet e shtetit të së drejtës po dështon të japë rezultate. Kjo ndoshta është me shqetësuesja, sepse vetëm institucionet e fuqishme të shtetit të së drejtës garantojnë që standardet e BE-së dhe të drejtat e qytetarëve dhe të kompanive mund të mbrohen.

## VLERËSIMI I PËRGATITJES SË MAQEDONISË SË VERIUT NDËR VITE

Vlerësimi mesatar i 33 kapitujve nga ana e Komisionit Evropian dëshmon se Maqedonia e Veriut nuk ka shënuar asnjë progres ndërmjet vitit të fundit të qeverisjes Gruevski (2015) dhe vitit 2022. **Pra, jemi përballë një stagnimi total, me përgatitje mesatare prej 3.0 të arritur në fund të qeverisjes Gruevskit dhe të pandryshuar deri në ditët e sotme (figura 2).**




Figura 2

Vlerësimi total i 33 kapitujve tregon për një progres thuajse të papërfillshëm prej 1.5 pikë nga gjithsej 165 në 7 vite (figura 3).




Figura 3

**Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi ka llogaritur se me këtë ritëm të reformave të dëshmuar gjatë qeverisjes SDSM-BDI, Maqedonisë së Veriut do t'i duhen hiç më pak se 306**

vjet për të përmbushur në tërësi standaret e BE-së. Pra, sipas kësaj dinamike, Maqedonia e Veriut do të arrinte përgatitje mirë të avancuar në vitin 2328.




Figura 4

## Përgatitja e Maqedonisë së Veriut sipas kllasterëve të negociatave

Meqë progresi në nivel të përgjithshëm është thujse i papërfillshëm, si qëndron gjendja në kllasterët individualë, sipas metodologjisë së re për zgjerim? A ka shenja progresi në kapituj të caktuar të negociatave për anëtarësim në BE?

Sa i përket parimeve të shtetit të së drejtës, sipas raporteve të progresit në periudhën 2015-2022, progres marginal prej 0.5 pikë është arritur sa i përket funksionimit të gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit dhe lirisë së shprehjes. Në luftën kundër krimit të organizuar, gjendja është po ajo e qeverisjes Gruevski, pra nuk është arritur asnjë progres. (figura 5).




Figura 5

Në kllasterin 1, Parimet themelore, niveli i përgatitjes nuk është përmirësuar thuhajse në asnjë kapitull nga viti 2015. Përgatitja në Prokurim publik; Statistika; Drejtësi, liri dhe siguri dhe; Kontroll financiar vazhdon të vlerësohet si mesatare (3). Vetëm në kapitullin 23, Gjyqësori dhe të drejtat themelore, ka një progres marginal prej 0.5 pikë por që përsëri dëshmon për një përgatitje të deridikushme në këtë fushë (figura 6).





Figura 6




**Sa i përket kllasterit 2, gjendja është e pandryshuar dhe progresi është i barabartë me zero.** Kapitulli më problematik vazhdon të jetë kapitulli 2, Liria e lëvizjes e punëtorëve, i vlerësuar si fazë e hershme e përgatitjes, me notë 1. Kapitulli 6, Ligji për shoqëritë tregtare, vazhdon të ketë përgatitje të mirë, me notë 4, njëjtë si në kohën e Gruevskit. Në kapitujt tjerë, përgatitja vazhdon të jetë mesatare (figurat 7 dhe 8).



Figurat 7 dhe 8

Në kllasterin 3, Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse, gjendja është më keq se në kohën e Gruevskit dhe nuk është shënuar asnjë progres në asnjë kapitull, përkundrazi. Këtu kemi regres në kapitullin 10, Transformimi dixhital dhe mediat, nga një përgatitje e mirë në vitin 2015 në një përgatitje mesatare në vitin 2022 (figurat 9 dhe 10).



Figurat 9 dhe 10

Gjendja është poashtu dëshpëruese edhe në kllasterin 4, ku kemi regres në kapitullin 27, Mjedisi dhe ndryshimet klimatike, nga një përgatitje mesatare në kohën e Gruevskit në një

përgatitje të deridikueshme, me notë 2 gjatë qeverisjes SDSM-BDI (figura 11).




Figura 11

Në kllasterin 5, Burimet natyrore, bujqësia dhe kohezioni, ka një dozë progresi, meqë kapitulli 12, Siguria ushqimore, veterinarë, fitosanitare, ka kaluar nga një përgatitje e deridikueshme në një përgatitje të të mirë, apo ngritje për dy pikë. Përndryshe, nuk ka progres në kapitujt tjerë, dhe kapitulli 33, Dispozitat financiare dhe buxhetore, vazhdon të jetë problematik me fazë të hershme të përgatitjes, me notë 1 (figura 12).




Figura 12

Dhe në fund, në kllasterin 6, poashtu është arritur progres falë harmonizimit të politikës së jashtme të vendit me Politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së (kapitulli 31), si pasojë e zbatimit të sanksioneve evropiane ndaj Rusisë pas invazionit të Ukrainës nga ana e qeverisë së Moskës. Në kapitullin 30, Marrëdhëniet e jashtme, nuk ka progres nga koha e Gruevskit (figura 13).




Figura 13

## KONKLUZION

Analiza e Institutit për Politika Publike Arbën Xhaferi të raporteve të progresit të Komisionit Evropian duke filluar nga viti 2015, që rastis të jetë edhe viti i fundit të qeverisjes Gruevski, e deri në raportin e fundit, të vitit 2022, dëshmon se impakti i reformave të qeverisë SDSM-BDI në përafrimin e Maqedonisë së Veriut me BE-në ka qenë i papërfillshëm.

Edhe pse është arritur progres në disa kapituj të negociatave për BE, siç janë Parimet e shtetit të së drejtës; Gjyqësori dhe të drejtat themelore; Siguria ushqimore, veterinare, fitosanitare si dhe; Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes, vendi ka shënuar kthim mbrapa në kapituj tjerë si Transformimi dixhital dhe mediat apo edhe Mjedisi dhe ndryshimet klimatike.

Si pasojë kemi një stagnim thuajse total, siç dëshmohet nga vlerësimi në tërësi i 33 kapitujve, ku vazhdojmë të kemi përgatitje mesatare, njëjtë si në vitin e fundit të qeverisjes Gruevski (2015). Me ritmin e reformave të qeverisjes SDSM-BDI, Maqedonisë së Veriut do t'i duhen hiç më pak se 306 vjet për të përmbushur në tërësi standaret e BE-së dhe për të arritur përgatitje mirë të avancuar.

Pra, raportet e progresit tregojnë se procesi i deritanishëm i zgjerimit ka dështuar të nxisë reforma të mirëfillta. Fatkeqësisht, nuk ka rrugë të shkurtër në përmbushjen e standardeve evropiane. Pa u krijuar bindja në kryeqytetet e BE-së se vendet candidate kanë përgatitje të mirë, nga peshkataria e deri të siguria nukleare, asnjë vend nuk do të mund të anëtarësohet.

Kjo do të ishte fatale për rajonin, duke ndikuar në klimën e investimeve të huaja dhe duke e bërë thuajse të pamundur arritjen e konvergencës midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre të BE-së. Andaj, angazhimi i BE-së në rajon duhet të fokusohet në dy akset kryesore që janë thelbi i Bashkimit Evropian:

- Rritja e konvergencës ekonomike dhe me tregun unik evropian, ndër tjera përmes ridinimizimit të Procesit të Berlinit.
- Krijimin e një nisme evropiane për shtetin e së drejtës, që fatkeqësisht u braktis si ide në Samitin e Sofjes (2018) në rrethana të paqarta edhe pse të gjithë partnerët e vendeve të Ballkanit Perëndimor pajtohen se mungesa e shtetit të së drejtës, kriminaliteti dhe korrupsioni vazhdojnë të jenë problemi më i madh i rajonit.

Nëse nuk adresohen seriozisht këto dy prioritete dhe procesi mbetet i pandryshuar, është e qartë se nuk do të ketë anëtarësime të reja në BE për dekada me radhë.

**Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi**

Rruga Dame Gruev, 7/8/3  
1000 Shkup  
Maqedonia e Veriut

Tel: +389 2 522 2922

E-mail: [info@ipp-arbenxhaferi.org](mailto:info@ipp-arbenxhaferi.org)

Web: [www.ipp-arbenxhaferi.org](http://www.ipp-arbenxhaferi.org)

**Përgatitja e Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në BE:  
të bllokuar në trashëgiminë e Gruevskit**

Mars 2023